

MILSPED ALBANIA SHPK

**Pasqyrat Financiare per vitin ushtrimor 2018
(se bashku me Raportin i Audituesit te Pavarur)**

PERMBAJTJA**Faqja**

| | |
|--|-------|
| RAPORTI I AUDITUESIT TE PAVARUR | i,iii |
| PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR | 1 |
| PASQYRA E TE ARDHURAVE DHE E TE ARDHURAVE TE TJERA GJITHEPERFSHIRESE | 2 |
| PASQYRA E NDRYSHIMEVE NE KAPITALIN NETO | 3 |
| PASQYRA E FLUKSIT TE MJETEVE MONETARE | 4 |
| SHENIMET SHPJEGUESE PER PASQYRAT FINANCIARE | 5-30 |

RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR

Për Drejtimin e Shoqërisë Milsped Albania Shpk

Opinionit

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Milsped Albania Shpk ("Shoqëria"), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar me 31 dhjetor 2018, pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin e mbyllur në atë datë, si dhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël dhe shënime të tjera shpjeguese.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për opinionin

Ne kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me Kodin e Etikës për Profesionistët Kontabël të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistët Kontabël (Kodi i BSNEPK) dhe me Kodin e Etikës të Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar në Shqipëri (Kodi i IEKA) që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Çështje të tjera në lidhje me informacionin krahasues

Pasqyrat financiare të Shoqërisë të përgatitura në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2017, janë audituar nga një auditues tjetër i cili shprehu një opinion të pamodifikuar mbi këto pasqyra financiare me 30 mars 2018.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likuidojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Përgjegjësia e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjese e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marreveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontroleve të brendshme.
- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinioni mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.
- Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, dhe bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesve në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Shoqëria të ndërpresë veprimtarinë.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në lidhje me to në një mënyrë që arrin paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me drejtimin, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Baker Tilly Albania shpk

Auditues Ligjor

Orjana Kalaja

Tirana, Albania

5 qershor 2019



MILSPED ALBANIA SHPK
PASQYRA E TE ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE GJITHEPERFSHIRESE
PASQYRAT FINANCIARE 2018

(Vlerat ne Leke)

| | Shënime | Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2018 | Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2017 | 1 Janar 2017 |
|--|---------|--|--|-------------------|
| Te ardhura nga aktiviteti i shfrytezimit | 17 | 356,714,477 | 293,309,071 | 193,120,242 |
| Lende e pare dhe materiale te konsumueshme | 18 | (1,249,010) | (632,637) | (2,379,271) |
| Shpenzime te tjera shfrytezimi | 19 | (256,680,656) | (193,295,203) | (117,057,284) |
| Shpenzime personeli | 20 | (53,700,293) | (42,513,859) | (32,153,017) |
| Shpenzime Amortizimi dhe Zhvleresimi | 6,7 | (13,870,283) | (13,169,856) | (15,215,742) |
| Shpenzime provigjoni per borxhin e keq | | (4,988) | (626,015) | - |
| Shpenzime financiare, neto | 21 | (2,116,046) | (2,731,328) | (3,147,475) |
| Fitimi / (Humbja) nga kurset e kembimit | 22 | 201,548 | (550,454) | (243,216) |
| Fitimi/(Humbja) Para Tatimit | | 29,294,749 | 39,789,720 | 22,924,237 |
| | 23 | | | |
| Shpenzime për tatimin mbi fitimin | | (5,233,996) | (6,316,958) | (3,643,817) |
| Fitimi neto per periudhen | | 24,060,753 | 33,472,762 | 19,280,420 |
| Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse | | - | - | - |
| Totali i të ardhurave/(humbjes) gjithëpërfshirëse për vitin | | 24,060,753 | 33,472,762 | 19,280,420 |

Pasqyra e te ardhurave gjithëpërfshirëse duhet lexuar se bashku me shenimet shpjeguese ne faqet 5 deri 30 qe jane pjese perberese e pasqyrave financiare.

Keto pasqyra financiare jane pergatitur nga dhe miratuar ne 5 qershor 2019 nga:

| | |
|---|---|
| Pergatitur nga Drejtuesja e Finances | Miratuar nga Administratori |
| Elpina Caci  | Marjeta Goce  Marko Divljan  |

MILSPED ALBANIA SHPK
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR
PASQYRAT FINANCIARE 2018
(Vlerat ne Leke)

| | Shënime | 31 Dhjetor 2018 | 31 Dhjetor 2017 | 1 Janar 2017 |
|---|---------|--------------------|--------------------|--------------------|
| Aktivët | | | | |
| Aktivët afatgjatë | | | | |
| Aktivë afatgjatë materiale | 6 | 97,380,023 | 55,184,961 | 59,471,279 |
| Aktivë afatgjatë jomateriale | 7 | 1,402,007 | 1,039,710 | 1,338,101 |
| Totali i aktiveve afatgjatë | | 98,782,030 | 56,224,671 | 60,809,380 |
| Aktivët afatshkurtra | | | | |
| Te drejta te arketueshme tregtare dhe te tjera te arketueshme | 8 | 76,777,245 | 76,471,032 | 65,149,962 |
| Inventari | 9 | 893,324 | 491,231 | 365,985 |
| Shpenzime te shtyra | 10 | 653,179 | 694,306 | 624,752 |
| Tatim fitimi I parapaguar | | 561,850 | - | - |
| Mjete monetare dhe te ngjashme | 11 | 23,477,868 | 38,366,914 | 19,760,991 |
| Totali i aktiveve afatshkurtra | | 102,363,466 | 116,023,483 | 85,901,690 |
| Totali i aktiveve | | 201,145,496 | 172,248,154 | 146,711,070 |
| Kapitali dhe Detyrimet | | | | |
| Kapitali aksionar | 12 | 56,108,000 | 56,108,000 | 56,108,000 |
| Fitim/(Humbja) e akumuluar | | 6,359,738 | 19,419,477 | 139,057 |
| Fitim/(Humbja) e vitit | | 24,060,753 | 33,472,762 | 19,280,420 |
| Totali i kapitalit të vet | | 86,528,491 | 109,000,239 | 75,527,477 |
| Detyrime afatgjatë | | | | |
| Huate nga institucionet financiare hua te tjera afatgjatë | 13 | 36,586,150 | 11,349,110 | 19,550,416 |
| Totali- Detyrime afatgjatë | | 36,586,150 | 11,349,110 | 19,550,416 |
| Detyrime afatshkurtra | | | | |
| Huate nga institucionet financiare | 13 | 16,023,495 | 9,936,307 | 11,343,227 |
| Furnitore dhe te tjera detyrime | 14 | 60,301,977 | 36,040,031 | 34,947,130 |
| Te pagueshme ndaj punonjesve | 15 | 1,105,172 | 982,382 | 806,568 |
| Te pagueshme per shpenzime te Detyrime tatimore | 16 | (66,733) | 199,915 | - |
| | | 666,944 | 4,740,170 | 4,536,252 |
| Totali i detyrimeve afatshkurtra | | 78,030,855 | 51,898,805 | 51,633,177 |
| Totali i detyrimeve | | 114,617,005 | 63,247,915 | 71,183,593 |
| Totali i kapitalit dhe detyrimeve | | 201,145,496 | 172,248,154 | 146,711,070 |

Pasqyra e pozicionit financiar duhet lexuar se bashku me shenimet shpjeguese ne faqet 5 deri 30 qe jane pjese perberese e pasqyrave financiare.

MILSPED ALBANIA SHPK
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NE KAPITAL
PASQYRAT FINANCIARE 2018
(Vlerat ne Leke)

| | Kapitali i nenshkruar | Fitimi i pashperndare | Fitimi/Humbja e vitit | Totali i kapitalit |
|--|----------------------------------|----------------------------------|----------------------------------|-------------------------------|
| Me 1 Janar 2017 | 56,108,000 | 139,059 | 19,280,418 | 75,527,477 |
| Te ardhurat totale gjithëpërfshirëse te vitit: | | | | |
| Kalim i fitimeve te vitit tek fitimi i pashperndare | - | 19,280,418 | (19,280,418) | - |
| Fitimi i vitit | - | - | 34,098,777 | 34,098,777 |
| Gjendje me 31 Dhjetor 2017 perpara rregullimit per efekte te SNRF 9 | 56,108,000 | 19,419,477 | 34,098,777 | 109,626,254 |
| Rregullimi per efekte te SNRF 9 | - | - | (626,015) | (626,015) |
| Gjendje me 31 Dhjetor 2017 pas rregullimit per efektet e SNRF 9 | 56,108,000 | 19,419,477 | 33,472,762 | 109,000,239 |
| Kalim i fitimeve te vitit tek fitimi i pashperndare | - | 33,472,762 | (33,472,762) | - |
| Fitimi i vitit | - | - | 24,060,753 | 24,060,753 |
| Pagese Dividenti | - | (46,532,501) | - | (46,532,501) |
| Gjendje me 31 Dhjetor 2018 | 56,108,000 | 6,359,738 | 24,060,753 | 86,528,491 |

Pasqyra e ndryshimeve ne kapital duhet lexuar se bashku me shenimet shpjeguese ne faqet 5 deri 30 qe jane pjese perberese e pasqyrave financiare.

MILSPED ALBANIA SHPK
PASQYRA E FLUKSIT TE MJETEVE MONETARE
PASQYRAT FINANCIARE 2018
(Vlerat ne Leke)

| | Viti 2018 | Viti 2017 |
|---|---------------------|--------------------|
| Fluksi mjeteve monetare nga/perdorur ne aktivitetin e shfrytezimit: | | |
| Fitimi/Humbja e vitit | 24,060,753 | 33,472,762 |
| <i>Rregullime per shpenzimet jo-monetare:</i> | | |
| Shpenzime zhvleresimi dhe amortizimi | 13,870,283 | 13,169,856 |
| Shpenzime per tatimin jomonetar | 5,233,996 | 6,316,958 |
| <i>Rregullime ne kapitalin qarkullues</i> | | |
| Zbritje/(rritje) ne inventar | (402,093) | (125,246) |
| Rritje/(zbritje) ne llogari te arketueshme | (306,213) | (11,321,070) |
| Rritje/(zbritje) ne shpenzime te shtyra | 41,127 | (69,554) |
| Rritje/(zbritje) ne detyrime te tjera | (4,339,875) | 403,831 |
| Tatim fitimi I paguar | (5,795,846) | (6,316,958) |
| Rritje/(zbritje) ne detyrime ndaj punonjesve | 122,790 | 175,814 |
| Rritje/(zbritje) ne detyrime te tjera afatgjata | 31,324,228 | (9,608,223) |
| Rritje/(zbritje) ne detyrimet e pagueshme | 24,261,946 | 1,092,901 |
| Mjete monetare neto nga/ perdorur ne aktivitetin e shfrytezimit | 88,071,096 | 27,191,071 |
| Fluksi i mjeteve monetare nga/ perdorur ne aktivitetin e investimit | | |
| Blerje e aktiveve afatgjata materiale | (56,427,642) | (8,585,148) |
| Mjete monetare neto nga/perdorur ne aktivitetin e investimit | (56,427,642) | (8,585,148) |
| Fluksi i mjeteve monetare nga/perdorur ne aktivitetin e financimit | | |
| Pagese Dividenti | (46,532,500) | - |
| Mjete monetare neto nga/perdorur ne aktivitetin e financimit | (46,532,500) | - |
| Rritje/(Renie) neto ne mjetet monetare dhe ekuivalente te mjeteve monetare | (14,889,046) | 18,605,923 |
| Mjete monetare dhe ekuivalente te mjeteve monetare ne fillim | 38,366,914 | 19,760,991 |
| Mjete monetare dhe ekuivalente te mjeteve monetare ne fund | 23,477,868 | 38,366,914 |

Pasqyra e flukseve monetare duhet lexuar se bashku me shenimet shpjeguese ne faqet 5 deri 30 qe jane pjese perberese e pasqyrave financiare.

MILSPED ALBANIA SHPK
SHENIME SHPJEGUESE PER PASQYRAT FINANCIARE
PASQYRAT FINANCIARE 2018
(Vlerat ne Leke)

1 Informacion i pergjithshem

Shoqeria Milsped Albania Sh.p.k (“Shoqeria”) u themelua si nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar me 03 Dhjetor 2013 ne Qendren e Kombetare te Regjistrimit dhe ka per objekt transportin e mallrave dhe te udhetareve me mjetet e shoqerise ose te te treteve, brenda dhe jashte vendit, si dhe ndermjetesimin ne transport.

Zyra e regjistrimit te Shoqerise eshte Kamez Tirane, Rruga Gryka e Kacanikut, Godina e Parkut Logjistik, Autostrada Tirane- Durrës, km 5.

Kapitali i shoqerise eshte 56,108,000 lek dhe perbehet nga 100 pjese me vlere 561,080 lek nje pjese

| Emri i Ortakut | Vlera e kapitalit | Numri i pjeseve | % e kapitalit | Vlera nominale e nje pjese |
|-----------------------|--------------------------|------------------------|----------------------|-----------------------------------|
| Milsped | 28,054,000 | 50 | 50% | 561,080 |
| Balfin | 28,054,000 | 50 | 50% | 561,080 |
| Totali | 56,108,000 | 100 | 100% | 561,080 |

Numri i punonjesve te Shoqerise me 31 Dhjetor 2018 ishte 60 punonjes (2017: 56 punonjes).

Pasqyrat financiare te shoqerise per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2018 jane miratuar nga Drejtimi i Shoqerise ne 5 qershor 2019.

2 Aplikimi i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar të reja dhe të rishikuara (SNRF)

a. Standardet dhe interpretimet efektive në periudhën aktuale

Standardet, amendimet dhe interpretimet në vijim, hyjnë në përdorim për herë të parë për periudhat që fillojnë në 1 Janar 2018 ose pas kësaj date:

- **SNRF 9 Blerësit e instrumentave financiar** (hyn në fuqi për periudhat që fillojnë nga 1 Janari 2018 ose pas kësaj date)
- **SNRF 15 Të ardhurat nga kontratat me blerësit** (hyn në fuqi për periudhat që fillojnë nga 1 Janari 2018 ose pas kësaj date); dhe

Nuk ka patur standarde apo interpretime të reja, të cilat kanë hyrë në përdorim për herë të parë për periudhat që fillojnë nga 1 Janari 2018 ose pas kësaj date, që të kenë efekt të qenësishëm në pasqyrat financiare të kompanisë.

2 Aplikimi i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar të reja dhe të rishikuara (SNRF) (vazhdim)

b. Standardet dhe interpretimet e emetuara por ende të papërvetësuara

Nje numer standardesh, amendimesh dhe interpretimesh hyjnë në përdorim për herë të parë për periudhat që fillojnë në 1 Janar 2018 ose pas kësaj date; e megjithate Shoqeria nuk i ka aplikuar keto standarde te reja ose te rishikuara ne pergatitjen e ketyre pasqyrave financiare. Asnje standard i ri nuk pritet te aplikohet me heret nga Shoqeria.

Nga këto standarde te cilat akoma nuk kane hyre ne fuqi, SNRF 16 pritet te kete nje ndikim material ne pasqyrat financiare te Shoqerise ne momentin e aplikimit fillestar.

SNRF 16 Qirate

IFRS 16 paraqet një model të vetëm kontabilizimi në bilanc për qiramarrësit. Një qiramarrës njih një të drejtë për të përdorur aktivin që përfaqëson të drejtën e përdorimit të këtij aktivi dhe njëkohësisht përbën edhe një detyrim qiraje që lidhet me obligimin për të shlyer pagesat e qirasë financiare. Ka disa përjashtime opsionale për qiratë afatshkurtra dhe qiratë për mjete me vlerë të vogël. Kontabilizimi për qiradhënësin mbetet shumë i ngjashëm me standardin aktual – për shembull, qiradhënësi do të vazhdojë ta klasifikojë qiranë si financiare ose operative.

SNRF 16 zëvendëson udhëzuesit aktualë të qirasë duke përfshirë SKK 17 Qiratë, KIRFN 4 Përcaktimi në rast se një marrëveshje përmban një qira, KIC-15 Qiratë operative – Incentivat dhe KIC-27 Vlerësimi i substancës së transaksioneve që përfshijnë formën ligjore të qirasë.

Standardi është efektiv për periudha vjetore që fillojnë më dhe pas 1 janar 2019.

SNRF 16 Qirate (Tranzicioni)

Shoqeria planifikon te aplikojte per here te pare SNRF 16 me 1 Janar 2019, duke perdorur metoden retrostpektive te modifikuar. Keshtuqe efektet e akumuluar te aplikimit te SNRF 16 do te njihen sin je rregullim i balancave hapese te Fitim/Humbjeve te mbartura me 1 Janar 2019, pa patur nevojte per riparacitje te informacionit krahasues.

Shoqeria planifikon te aplikojte menyren praktike te “Grandfathering” te perkufizimit te qirase ne tranzicion. Kjo do me thene qe SNRF 16 do te zbatohet ne te gjitha kontratat e lidhura perpara 1 Janarit 2019 dhe te cilat kane gene te identifikuar si kontrata qiraje ne perputhje me SNK 17 dhe KIRFN 4.

Amendime të tjera

Standardet e reja apo të ndryshuara më poshtë nuk pritet të kenë efekt të rëndësishëm mbi pasqyrat financiare të Shoqërisë:

- 2 IKIRFN 23 Pasiguri ne Trajtimet Tatimore.
- 3 Vecorite parapaguese me kompensim negativ (Amendime te SNRF 9).
- 4 Interesat afatgjate ne Dege dhe Shoqeri te Perbashketa (Amendime te SNK 28).
- 5 Ndryshimi i planit, reduktimi ose shlyerja (Amendime te SNK 19).
- 6 Permiresimet vjetore ne SNRF 2015–2017 standarte te ndryshme.
- 7 Amendime te referencave ne kuadrin konceptual te standarteve SNRF.
- 8 SNRF 17 Kontratat e Sigurimit.

3 Politika kontabël të rëndësishme

3.1 Baza e përgatitjes dhe përputhshmërisë

a. Baza e përputhshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (“SNRF”) publikuar nga Bordi i Standarteve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (“BSNK”) dhe interpretimet e publikuara nga Komisioni i Interpretimeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (“KINRF”) të BSNK. Zbatimi i SNRF-ve është sipas Ligjit Nr.9228 datë 29.04.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” dhe Vendimin e Keshillit të Ministrave Nr. 742. datë 7.11.2007. Pasqyrat financiare janë përgatitur duke përdorur bazat e vlerësimit të specifikuar nga SNRF për çdo klasë të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Bazat e vlerësimit janë përshkruar në mënyrë më të qartë në politikat kontabël të paraqitura si më poshtë.

b. Baza e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur duke u bazuar në koston historike.

c. Monedha funksionale dhe raportuese

Pasqyrat Financiare janë pasqyruar në “Lek” e cila është monedha funksionale e shoqërisë.

d. Përdorimi i gjykimit dhe i vlerësimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF kërkon që drejtimi i shoqërisë të bëjë gjykime. vlerësime dhe supozime që mund të ndikojnë në aplikimin e politikave si dhe vlerave të raportuara të aktiveve dhe detyrimeve. të ardhurave dhe shpenzimeve. Vlerësimet dhe supozimet kryesore janë rishikuar në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në çdo periudhë të ardhshme në të cilën mund të ketë ndikim.

3.2 Parimi i vijimësisë

Te dhenat e kontabilitetit janë mbajtur duke qene ne perputhje me parimet e pergjithshme te kontabilitetit, ne menyre te vecante me bazen e matjes me kosto historike, parimin e kontabilitetit rrjedhes, konceptin e kujdesit dhe me supozimin e biznesit ne vijimesi.

Pasqyrat financiare jane pergatitur sipas parimit te vijimesise, i cili parashikon realizimin e aktiveve dhe shlyerjen e detyrimeve gjate ecurise normale te biznesit.

3 Politika kontabël të rëndësishme

3.3 Transaksione në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj janë konvertuar në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së transaksionit. Të gjitha humbjet dhe fitimet nga kursi i këmbimit që rezultojnë nga kryerja e këtyre transaksioneve dhe nga rivlerësimi i zërave monetare në monedhë të huaj me kursin e këmbimit të fundit të vitit njihen në fitim ose humbje.

Zërat jo-monetare nuk ri këmben në fund të periudhës dhe maten me kosto historike (këmben duke përdorur kursin e këmbimit në datë kur është kryer transaksioni), përveç rasteve kur zërat jo-monetare maten me vlerë të drejtë të cilat këmben duke përdorur kurset e këmbimit në datën kur është përcaktuar vlera e drejtë.

Kurset zyrtare të aplikuara (Lek kundrejt monedhave të tjera të huaja) për monedhat kryesore me 31 Dhjetor 2018 dhe 2017 janë si më poshtë:

| | 31 Dhjetor 2018 | 31 Dhjetor 2017 |
|-----|------------------------|------------------------|
| EUR | 123.42 | 132.95 |
| USD | 107.82 | 111.10 |

3.4 Aktivët afatgjatë materiale

(i) Njohja dhe matja

Te gjitha aktivët afat-gjatë materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar. Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivitetit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndertuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivitetit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes si në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivitetit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bera gjatë ndertimit kapitalizohen në “Ndertim në proces” dhe transferohen në kategorinë perkatese të aktivitetit kur përfundon ndertimi tij, nga kur aplikohet amortizimi perkates sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktiviteti afatgjatë material kanë jetegjatesi të ndryshme. Ato kontabilizohen si zera të ndryshme (komponentet me të mëdhenj) të aktiveve afat-gjatë materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur, dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave.

(ii) Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjesë të një zeri të aktiveve afatgjatë materiale njihet në vlerën kontabel të atij zeri nëse është e mundur që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afat-gjatë materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

(iii) Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur zbritese të amortizimit, mbi jetën e vlerësuar të çdo pjesë të aktivitetit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes, për të gjitha klasat e aktiveve afatgjatë materiale përveç “mobilje dhe pajisje zyre” për të cilat përdoret metoda lineare e amortizimit. Aktivët e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën me të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit. Toka nuk amortizohet.

Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në çdo datë raportimi. Aktivët afatgjatë jomateriale njihen atëherë kur është e mundur që të përfitime ekonomike do të sigurohen në të ardhmen në lidhje me këto aktive dhe kostoja e tyre mund të matet në mënyrë të besueshme.

3. Politika kontabël të rëndësishme (vazhdim)

3.5 Aktivet afatgjata jo materiale

Aktivitet afatgjata jo-materiale të blera nga shoqëria paraqiten me kosto historike minus amortizimin e akumuluar dhe çdo humbje tjetër nga rënia në vlerë (nëse ka), bazuar në jetëgjatësinë e vlerësuar pas datës së cilës ato janë të gatshme për përdorim. Jetëgjatësia dhe metoda e amortizimit të aktiveve afatgjata jo-materiale shqyrtohet, në çdo datë të pasqyrës së pozicionit financiar dhe efektet e ndryshimit merren parasysh në periudhat e ardhshme. Vlera kontabël e aktiveve jo-financiare të shoqërisë përveç inventarit dhe aktiveve tatimore të shtyra, shqyrtohen në çdo datë të pasqyrës së pozicionit financiar për të përcaktuar nëse ka ndonjë tregues për zhvlerësim. Nëse ndonjë tregues i tillë ekziston, atëherë vlera e rikuperueshme e aktivitet rivlerësohet. Kur vlera kontabël e tejkalon vlerën e rikuperueshme, njihet një humbje nga zhvlerësimi. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në fitim ose humbje.

3.6 Zhvlerësimi i aktiveve jo-financiare

Një humbje nga zhvlerësimi njihet nëse vlera kontabël e një aktivi ose njësisë gjeneruese të mjeteve monetare është më e vogël se vlera e tij e rikuperueshme. Një njësi gjeneruese e mjeteve monetare është grupi më i vogël i identifikueshëm i aktiveve që gjeneron flukse monetare në mënyrë të pavarur nga aktivitet apo grupet e tjera të aktiveve. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në fitim ose humbje. Vlera e rikuperueshme e një aktivi ose e njësisë gjeneruese të mjeteve monetare është vlera më e madhe midis vlerës në përdorim dhe vlerës së drejtë minus kostot e shitjes. Në vlerësimin e vlerës në përdorim, flukset monetare të ardhshme skontojnë për ti sjellë në vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë skontimi para taksave e cila reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe rrezikun specifik të aktivitet.

Në lidhje me aktivitet e tjera, një humbje nga zhvlerësimi rimerret në qoftë se ka ndonjë tregues që ky zhvlerësim nuk ekziston më dhe ka pasur ndryshime në vlerësimet e përdorura për të përcaktuar vlerat e rikuperueshme. Një humbje nga zhvlerësimi rimerret deri në masën që vlera kontabël e aktivitet nuk e kalon vlerën kontabël që do të ishte përcaktuar, neto nga amortizimi dhe zhvlerësimi, në qoftë se asnjë humbje nga zhvlerësimi nuk është njohur.

3.7 Inventarët

Inventarët maten me vlerën më të vogël midis koston dhe vlerës neto të realizueshme. Vlera neto e realizueshme është çmimi i vlerësuar i shitjes në rrjedhën normale të biznesit, minus kostot e çmuara të përfundimit dhe kostot e çmuara që duhen për realizimin e shitjes.

Kostot e inventarit përcaktohen duke u bazuar në metodën e mesatares së ponderuar, e cila përfshin të gjitha kostot e blerjes, transportit, tarifave doganore dhe sigurimit gjatë transportit, kostot e konvertimit dhe çdo kosto tjetër që lidhet me inventarin për të sjellë atë në vendin dhe kushtet e punës.

3. Politika kontabël të rëndësishme (vazhdim)

3.8 Instrumentet financiare

Aktivet financiare dhe detyrimet financiare njihen kur Shoqëria bëhet palë e dispozitave kontraktuale të instrumentave financiarë dhe matet fillimisht me vlerën e drejtë të rregulluar për kostot e transaksionit, me përjashtim të atyre të mbajtura me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes të cilat fillimisht janë të matura me vlerë të drejtë dhe kostot e transaksionit janë shpenzuar në fitimin ose humbjen.

i. Klasifikimi dhe matja e aktiveve financiare dhe detyrimeve financiare.

SNRF 9 përmban tre kategori kryesore të klasifikimit për aktivet financiare: matur me koston e amortizuar, vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera përmbledhëse ose me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes. Klasifikimi i aktiveve financiare sipas SNRF 9 në përgjithësi bazohet në modelin e biznesit në të cilin menaxhohet një aktiv financiar dhe karakteristikat e flukseve monetare kontraktuale të aktivitetit financiar. SNRF 9 eliminon kategoritë e mëparshme të SNK 39, të mbajtura deri në maturim, huatë dhe llogaritë e arkëtueshme dhe të mbajtura për shitje. Sipas SNRF 9, derivativët e përfshirë në kontratat ku baza është një aktiv financiar në këndvështrimin e standardit nuk ndahen kurrë. Në vend të kësaj, instrumenti financiar hibrid si një i tërë vlerësohet për klasifikim.

SNRF 9 kryesisht ruan kërkesat ekzistuese në SNK 39 për klasifikimin dhe matjen e pasiveve financiare.

Miratimi i SNRF 9 nuk ka pasur efekt të rëndësishëm në politikat kontabël të Kompanisë lidhur me pasivet financiare.

i. Klasifikimi dhe matja e aktiveve financiare dhe detyrimeve financiare (vazhdim)

Efekti i adoptimit të SNRF 9 mbi vlerat kontabël të aktiveve financiare më 1 Janar 2018 lidhet vetëm me kërkesat e reja të zhvlerësimit.

ii. Zhvlerësimi i aktiveve financiare

SNRF 9 zëvendëson modelin e humbjeve të ndodhura në SNK 39 me një model të humbjes së pritshme të kredisë. Modeli i ri i zhvlerësimit zbatohet për aktivet financiare të matura me koston e amortizuar. Sipas SNRF 9, humbjet nga kreditë njihen më herët se në SNK 39. Për aktivet në kuadër të modelit të SNRF 9, humbjet nga zhvlerësimi zakonisht pritet të rriten dhe të bëhen më të paqëndrueshme.

3.9 Kapitali aksionar

Kapitali aksionar konsiston në mjetet monetare të kontribuara nga themeluesit e shoqërisë. Kapitali aksionar paraqitet me vlerën në Lek. Kapitali aksionar i shoqërisë njihet me vlerë nominale.

3.10 Njohja e të ardhurave

Sipas SNRF 15 të ardhurat do të njihen në masën që është pothuajse e sigurtë se një kthim në sasinë e të ardhurave të akumuluar të njohura nuk do të ndodhë. Kështu e ardhura matet duke u bazuar në shumën e percaktuar në kontratë me klientin ose në listen e cmimeve të Shoqërisë. Shoqëria e njeh të ardhurën atëherë kur ajo transferon kontrollin mbi shërbimin ose mallin tek klienti.

Shoqëria do të njohë të ardhurat në një pikë në kohë që do të perfaqësohet nga momenti që klienti pranon shërbimet e ofruara nga shoqëria si edhe merr persiper rreziqet e këtij transferimi të shërbimeve, me supozimin se nuk do të ketë kthime të rëndësishme në këto shërbime.

Shitjet e shërbimeve:

Të ardhurat njihen gjatë kohës kur ofrohen shërbimet. Faza e përfundimit për përcaktimin e shumës së të ardhurave për t'u njohur vlerësohet bazuar në anketat e punës së kryer. Nëse shërbimet sipas një marrëveshjeje të vetme jepen në periudha të ndryshme raportimi, atëherë shuma ndahet në bazë të çmimeve të tyre të shitjes.

3. Politika kontabël të rëndësishme (vazhdim)

3.11 Përfitimet e punonjësve

Kontributet e detyrueshme për sigurime shoqërore.

Gjatë ushtrimit të aktivitetit operativ, shoqëria kryen pagesa periodike për llogari të punonjësve për pjesën që ligjërisht i takon të paguajë shoqërisë dhe punonjësve për të kontribuar për fondet e detyrueshme të pensioneve sipas rregullimeve të legjislacionit vendas. Kostot e shoqërisë janë përfshirë në llogaritjen e rezultatit të periudhës.

3.12 Tatim fitimi i vitit dhe tatim fitimi i shtyre

Shpenzimet për tatim fitimin përfshijnë tatim fitimin aktual dhe tatim fitimin e shtyre. Shpenzimet për tatim fitimin njihen në fitim ose humbje deri përveç pjesës që lidhet me zëra të njohur direkt në kapital ose në të ardhurat e tjera përmbledhëse.

Tatimi mbi fitimin aktual është tatimi i pagueshëm mbi të ardhurat e tatueshme duke përdorur normat e taksimit në datën e raportimit dhe çdo rregullim i tatimit të pagueshëm të lidhur me vitin e kaluar. Tatimi mbi fitimin i aplikueshëm është 15% e fitimit të tatueshëm.

Tatim fitimi i shtyre njihet në lidhje me diferencat e përkohshme midis vlerës kontabël të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të përdorura për qëllime tatimore. Tatimi i shtyre matet me normat tatimore që pritet të aplikohen për diferencat e përkohshme kur ato ndryshojnë, duke u bazuar në ligjet që kanë qenë ose janë në fuqi në datën e raportimit.

Një aktiv tatimor i shtyre njihet në masën që është e mundur që fitime të ardhshme të tatueshme do të jenë në dispozicion për të mbuluar diferencat e përkohshme. Aktivet tatimore të shtyra rishikohen në çdo datë raportimi dhe reduktohen në qoftë se përfitimet tatimore nuk do të jenë më të mundshme për tu realizuar.

3.13 Provizionet

Provizionet njihen kur shoqëria ka një detyrim aktual (ligjor ose konstruktiv) si rezultat i ngjarjeve të kaluara dhe është e mundur që një rrjedhje e burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike do të jetë e nevojshme për të shlyer detyrimin dhe kur një vlerësim i besueshëm i vlerës së detyrimit mund të bëhet. Nëse efekti është material, provizionet llogariten duke zbritur vlerën e pritshme të mjeteve monetare të ardhshme para tatimit që reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë, dhe kur është e nevojshme rrezikun specifik të detyrimit.

Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk është më e mundshme që një dalje e burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike do të kërkohet për të shlyer detyrimin, provigjoni anulohet. Provizionet përdoren vetëm për qëllimet e njohura fillimisht. Provizionet nuk njihen për humbje të ardhme operative. Angazhimet dhe detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në kontabilitet.

Provizionet për kthimin e mallrave të shitura do të njihen si “detyrime për kthimin e shitjeve” për vlerën e të ardhurave nga shitja e tyre me kundraparti pakësimin e të ardhurave nga shitja; dhe “te drejta për kthimet e shitjeve” për të pasqyruar te drejtën për të rimarrë produktet nga konsumatorët në zgjidhjen e përgjegjësisë për rimbursim, me kundraparti pakësimin e kostos së mallrave të shitura.

3. Politika kontabël të rëndësishme (vazhdim)

3.14 Angazhime dhe detyrime të kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato pasqyrohen në shënimet shpjeguese nëse mundësia e daljes së burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e ulët. Aktivët e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare por paraqiten në shënimet shpjeguese kur mundësia e të ardhurave ekonomike është e mundshme. Shuma e një humbje të kushtëzuar njihet si provigjon nëse është e mundshme që ngjarje të ardhshme do të konfirmojnë provigjonin. një detyrim njihet ne datën e Pasqyrës e pozicionit financiar kur një vlerësim i pranueshëm i humbjes mund të bëhet ne mënyrë të besueshme.

3.15 Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përbëhen nga aksionarë dhe drejtorët e shoqërisë. së bashku me entitete që ata kontrollojnë. të cilët mund të ushtrojnë influencë të konsiderueshme në operacionet dhe menaxhimin e shoqërisë. Duke konsideruar çdo palë të mundshme . vëmendje i kushtohet thelbit të marrëdhënies dhe jo vetëm formës ligjore.

3.16 Ngjarjet pas datës së raportimit

Ngjarjet pas datës së bilancit që ofrojnë informacion shtesë për pozicionin e shoqërisë në datën e Pasqyrës se pozicionit financiar (veprimet rregulluese). janë të reflektuara në pasqyrat financiare. Ngjarjet pas datës së bilancit që nuk janë ngjarje për veprime rregulluese janë pasqyruar në shënimet shpjeguese kur janë materiale.

3.17 Parapagime per sherbime

Parapagime per sherbimet jane njohur ne aktive ne masen e sherbimit te kontraktuar midis furnitorit dhe Shoqerise per kryerjen e sherbimeve te caktuara ne funksion te aktivitetit primar.

MILSPED ALBANIA SHPK
SHENIME SHPJEGUESE PER PASQYRAT FINANCIARE
PASQYRAT FINANCIARE 2018
(Vlerat ne Leke)

4 Menaxhimi i rrezikut financiar

4.1 Faktorët e rrezikut financiar

Aktivitetet e shoqërisë e ekspozojnë atë ndaj një shumëllojshmërie rreziqesh financiare. që përfshijnë rrezikun e kreditit dhe rrezikun e lidhur me efektet e ndryshimit në kursin e këmbimit të monedhave të huaja dhe normat e interesit. Menaxhimi i rrezikut të shoqërisë fokusohet në paparashikueshmërinë e tregjeve dhe synon të minimizojë efektet potenciale të kundërta mbi performancën e biznesit të shoqërisë. Menaxhimi i rrezikut kryhet nga drejtimi bazuar në politika të aprovuara dhe procedura që mbulojnë gjithë menaxhimin e rrezikut. si dhe çështje specifike, si rreziku i kursit të këmbimit, rreziku i normës së interesit, rreziku i kreditit, dhe investimi i likuiditetit të tepërt.

4.2 Rreziku i tregut

Rreziku i kursit të këmbimit

Shoqëria është e ekspozuar ndaj rrezikut të kursit të këmbimit që vjen si rezultat i ekspozimit në monedha të ndryshme kryesisht në lidhje me Euro-n. Shoqëria nuk përdor ndonjë instrument për tu mbrojtur ndaj rrezikut të kursit të këmbimit. Drejtimi i shoqërisë është përgjegjës për të mbajtur pozicione neto të përshtatshme në çdo monedhë dhe në total dhe të monitorojë operacionet e përditshme. Vlera kontabël e aktiveve dhe detyrimeve financiare të shoqërisë të shprehura në monedhë të huaj në 31 Dhjetor 2018 është si më poshtë:

| | 31 Dhjetor 2018 | | | |
